



Pranuar / Dostiguar Prenjten / Pristato Received / Delivery	23.06.2022	2	viti god. year
Organ / Njësia Org / Unit	Nr. Prot Is. Prot Prot No	Shtojca Pulog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPMSTAK	3668/2022		113



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.516/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës- Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Jeton Koca-anëtar si dhe Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.516/2022 të datës 09.06.2022, të parashtruar nga ankuesja me adresë banimi

kundër organit të punësimit/Ministria e Punëve të Brendshme në çështjen juridike "vlerësim i punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1,nenin 16 paragrafi 3, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datën 23.06.2022, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.516/2022, e datës 09.06.2022 e parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Ankuesja është e punësuar në Ministrinë e Punëve të Brendshme ,sipas ndryshimit të akt emërimit të datës 18.03.2014, në pozitën "Inspektore për Sigurimin e Aviacionit Civil", në Departamentin për Siguri Publike pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme. Me datën 06.05.2022, Udhëheqësi i drejtpërdrejtë i ankueses ka bërë rivlerësimin e rezultateve në punë për ankuesen, pas pranimit të Vendimit me numër A.nr.164/2022 të datës 22.04.2022, të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Ankuesja e pakënaqur me rivlerësimin e rezultateve në punë nga Udhëheqësi i saj i drejtpërdrejtë, me datën 09.06.2022 ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 3348/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, vlerësimit jo meritore si dhe për shkak të shkeljeve procedurale të procesit të vlerësimit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova; Ankesën me numër të protokollit 3348/2022 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Formularin për rivlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2021 për ankuesen i datës 06.05.2022; Kërkesën për informata shtesë përmes e-mailit zyrtar të datës 13.06.2022 me numër 3442/2022 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për ankuesen; Përgjigjen në kërkesë përmes e-mailit zyrtar të datës 13.06.2022 me numër 3443/2022 nga ankuesja për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mailin zyrtar të datës 13.06.2022 me numër 3445/2022 nga Ministria e Punëve të Brendshme; Vendimin me numër A.nr.164/2022 të datës 22.04.2022 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2021 të datës 25.01.2022; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin për vitin 2018 të datës 31.12.2019; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin për vitin 2019 të datës 14.12.2020; Ndryshimi i akt emërimit të datës 18.03.2014 i ankueses; E-mailat zyrtar të datës 05.05.2022; E-mailin zyrtar të datës 11.05.2022; Emaili zyrtar i datës 05.05.2022; E-mailin zyrtar të datës 21.12.2021; Njoftimin e datës 10.05.2022 lidhur me zbatimin e vendimit të Këshillit; Procesverbalin e kolegjit për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave të datës 22.04.2022 ; Vendimin me numër VK.nr.25/2022 të datës 08.04.2022; Ankesën e datës 24.02.2022 të datës; E-mailin zyrtar te datës 25.01.2022; E-mailat zyrtar te datës 31.01.2022; E-mailat zyrtar te datës 21.01.2022; E-mailin zyrtar te datës 03.02.2022, 06.02.2022 dhe 07.02.2022; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 03.03.2022 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 04.04.2022 nga Ministria e Punëve të Brendshme me provat e bashkangjitura të lëndës; Komunikimin përmes viberit të datës 28.01.2022; Planet vjetore të punës lidhur me objektivat dhe aktivitetet e realizuara për vitin 2021,2022 nga ankuesja; Përshkrimin e detyrave të punës së ankueses; Plani i divizionit për sigurim të aviacionit për vitin 2021; E-mailin zyrtar të datës 20.11.2020; Vendimin me numër Nr.120/2021 të datës 25.02.2021 nga Ministria e Punëve te Brendshme; E-mailin zyrtar te dateds 12.07.2020; E-mailin zyrtar te datës 01.12.2020; E-mailin zyrtar të datës 30.04.2021; E-mailin zyrtar të datës 11.08.2020; E-mailin zyrtar te datës 10.08.2020; Planin vjetor te departamentit për siguri publike për vitin 2022; Vendimin me numër Nr.181/2022 te datës 09.02.2022 nga Ministria e Punëve të Brendshme; E-mailin zyrtare te datës 03.02.2022; E-mailin zyrtar te datës 21.01.2022; E-mailat zyrtar te datës 12.01.2022, 14.01.2022; E-mailin zyrtar te datës 14.09.2021; E-mailin zyrtar te datës 30.07.2021.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankueses *është e pa lejuar,*
sepse:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ndërlidhur me lëndën e ankueses, ka shqyrtuar pranueshmërinë e formularit të rivlerësimit për vitin 2021 të datës 06.05.2022 nga ana e ankueses dhe në këtë drejtim me datën 13.06.2022 përmes shkresës me numër 3442/2022 sipas e-mailit zyrtar, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka kërkuar informata zyrtare nga ana e ankueses, lidhur me pranueshmërinë e Formularit të rivlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2021 të datës 06.05.2022 nga ana e saj, citoj : *“Luteni të na konfirmoni se Formularin për rivlerësimin e rezultateve në punë të datës 06.05.2022 kur e keni pranuar”* dhe e njëjta me datën 13.06.2022 përmes shkresës me numër 3443/2022 e sipas e-mailit zyrtar ka kthyer përgjigjen , citoj : *“Formularin lidhur me rivlerësimin e rezultateve në punë e kam pranuar nga udhëheqësi im i drejtpërdrejtë me datën 06.05.2022...”*. Po ashtu me datën 13.06.2022 përmes shkresës me numër 3445/2022 e sipas e-mailit zyrtar, Zyrtari i lartë i



personelit pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme ka përcjellë komunikimin zyrtar ndërmjet tij dhe Udhëheqësit të drejtpërdrejtë të ankueses të datës 06.05.2022, i cili ndër të tjera deklaroi se, citoj: *"Bashkangjitur gjeni formularin e vlerësimit për zyrtaren dhe vendimin e KPMSHCK-së. Për informimin tuaj, sot e kam mbajtur takimin me zyrtaren lidhur me vlerësimin dhe e njëjta deri më tani nuk e ka nënshkruar dhe as refuzuar vlerësimin, andaj formulari origjinal është tek"*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka analizuar shkresat e lëndës e ndërlidhur me afatshmërinë e ankesës së ankueses, ka konstatuar se ankuesja Formularin lidhur me rivlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2021 të datës 06.05.2022 e ka pranuar po me këtë datë, ndërsa ankesën në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e ka parashtruar me datën 09.06.2022, e që është jashtë afatit ligjor të përcaktuar me nenin 127 paragrafin 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: *"Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve, nga data kur është njoftuar për aktin administrativ"*, andaj në kuptim të kësaj dhe nenit 18 paragrafit 1 nën paragrafit 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ankesa e ankueses është e pa lejuar.

Andaj, duke u bazuar në nenin 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.516/2022, datë 23.06.2022

Ardita DERCIJKU-SHYTI

Zyrtarë e lartë për bashkëpunim profesional

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- ❖ Ankueses
- ❖ Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme;
- ❖ Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe
- ❖ Arkivit të KPMSHCK-së.